



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 17

Datë: 11. 05. 2023. Ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes Nr.11,12,13 dhe 14/2023

2. Aktivitetet e SKQZ-së

3. Raportet e Këshillave të KQZ-së

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për realizimit e Planit të Punës të KQZ-së për periudhën janar-mars 2023.

- Shqyrtimi dhe miratimi i konkursit për kompozimin e Melodisë së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i agjendës për “Punëtorin për përmirësimin e listës së votuesve e përkrahur dhe financuar nga OSBE”.

- **Këshilli për Buxhet dhe Financa**

- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të shpenzimeve të derivateve për veturat e KQZ-së për periudhën janar-mars 2023.
- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit tremujor financiar të KQZ-së për periudhën janar-mars 2023.

- **Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë**

4. Njoftim nga pjesëmarrja në programin ndërkombëtar të vizitorëve në vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare në Estoni.

5. Njoftim nga pjesëmarrja në vëzhgimi i zgjedhjeve presidenciale në Republikën e Malit të Zi.

6. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes Nr.11,12,13 dhe 14/2023

Kryetari Radoniqi, fillimisht përshëndeti anëtarët dhe të pranishmit, dhe pastaj paraqiti agjendën e takimit. Anëtarja Gordana Llaban, kërkoi që pika e rëndit nga Këshilli për Buxhet dhe Financa: “Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të shpenzimeve të derivateve për veturat e KQZ-së për periudhën janar-mars 2023” të largohet nga shqyrtimi, meqë edhe pak duhet të plotësohet me të dhëna...

Në vazhdim me 9 vota për, u miratua rendi i ditës. Pastaj, u miratuan procesverbalet nga mbledhjet e KQZ-së nr. 11,12,13 dhe 14/2023.

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Në mes të dy takimeve të mbledhjeve, kryeshefi Burim Ahmataj e njoftoi KQZ-në mbi aktivitetet e Sekretariatit, dhe ai tha se 13 prill 2023, nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), e ka pranuar draft Raportin e Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të KQZ-së për vitin 2022 dhe KQZ ka kthyer letër konfirmimin

me datë 27 Prill 2023, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të Raportit. Raporti pritet të prezantohet në mbledhjen e radhës së Komitetit të Auditimit, që do të jetë brenda muajit maj 2023.

Bazuar në Vendimin e KQZ-së Nr.01/521/2023 i datës 23.04.2023, për pagesat e stafit të angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV), Sekretariati i ka marrë të gjitha veprimet për pagesat e stafit të angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV). Nga Mitrovica e Veriut janë paguar 69 anëtar të KVV, Zveçan 22 anëtar të KVV, Zubin Potok 9 anëtar të KVV dhe Leposaviq 37 anëtar KVV, gjithsej 137 anëtar të KVV dhe staf teknik. Në komunat Zveçan dhe Zubin Potok, në disa vendvotime, anëtar të KVV kanë qenë të angazhuar Zyrtarët e Lartë Komunal të Zgjedhjeve, pagesa e të cilëve do të bëhet njëjtë sikur stafi i SKQZ përmes punës jashtë orarit. Për realizimin e votimit të kategorisë së personave me nevoja të veçanta përkatësisht kategorisë së të ngjuarve nëpër institucione, kanë qenë dy ekipe mobile me nga tre (3) anëtar që kryesoheshin nga Zyrtarët e Lartë Komunal të Zgjedhjeve.

Burim Ahmetaj tha se, janë realizuar edhe pagesat e stafit jo permanent, dhe pagesat e faturave të kontratave të furnizimeve dhe shërbimeve janë në proces. Ai, tha se divizioni i trajnimit ka hartuar draftin e strategjisë për trajnimin e Trupave Menaxhuese Zgjedhore, aktivitet i bartur nga Plani i Punës për vitin 2022, duke analizuar të gjitha raportet e brendshme të akterëve tjerë pjesëmarrës në proceset zgjedhore, si dhe ka bërë harmonizimin e të gjitha raporteve dhe analizave, të cilat kane shërbyer si të dhëna/gjetura determinuese për përpilimin e strategjisë në fjalë.

Gjithashtu, z. Ahmetaj e informoi KQZ-në se në bashkëpunim me Divizionin e informimit publik, Shërbimi Votues është duke hartuar projektin për informimin e votuesve që janë caktuar në qendrat e reja të votimit. Po ashtu, në koordinim me DKT, ShV është në përgatitje të planit të trajnimit të ZLKZ-ve për përdorimin e aplikacionit për ndërrim të qendrës së votimi. Ky trajnim planifikohet të mbahet në javën e parë të qershorit.

Kryeshefi Ahmetaj, ndër aktivitetet e tjera përmendi edhe mbikqyrjen e zhvillimit të softuerit të integruar të rezultateve, finalizimin e planit strategjik të KQZ 2023-2026, dhe identifikimin e ndryshimit të rregulloreve të KQZ-së të miratuara nga KQZ për t'i prezantuar ato, tek ZLKZ.

Arianit Elshani, tha se “e vlerësoj punën e sekretariatit”, por unë do të bëjë disa analiza shtesë në aktivitetet e planit të punës, veçanërisht në aktivitetin që po bëhet për herë të parë nga KQZ, ajo e “periudhës së shërbimit të votuesve për ndërrimin e qendrave të votimit”, e që nuk ka qenë asnjëherë i zbatuar në të kaluarën por, vetëm në periudhave zgjedhore...Tani, për herë të parë KQZ-ja do të ofrojë mundësinë për “ndërrimin e qendrave të votimit” deri në 40 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve...Si këshill,

kemi kërkuar të kemi që të kemi një plan veprimi të detajshëm, sidomos rreth informimit të publikut...Lidhur me zhvillimin e “soëvtverit të integruar të rezultateve”, edhe ky është një hap i madh dhe gjatë qershorit sipas afatit presim të filloj testimi...etj.

Edhe tjerat veprime, janë për tu vlerësuar. Tash, edhe finalizimi i planit strategjik shpresojmë që, të jetë gati për miratim në KQZ, me ato pak çështje që mund të jenë...

Sami Hamiti, pyeti rreth draftit- raportit të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare. A keni ba komente ? Nuk mund të trajtohet në maj, por unë mendoj se më heret duhet ta shohim, unë personalisht dua ta shoh...Konsideroj se është dashur me dhënë komente...Dhe, ka qenë mirë që të konsultoheshim...

Gjithashtu, pyetje shtroi edhe **Sami Kurteshi** rreth softverit, sepse tha ai, rreth plotësim – ndryshimit të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, ky po shkon përpara... Ahmetaj, u përgjegj pozitivisht. Aty janë edhe qendrat komunale të numërimit, a keni diskutuar që të futen edhe ‘qendrat komunale të numërimit’?, ishte një pyetje tjetër e z. Kurteshit. A keni diskutue sepse, softveri ka me pas ndryshime...

Burim Ahmetaj, tha se softveri pasi ti kalojë të gjitha testimet, I jepet në pronës KQZ, i jepen kodet burimore...

Arianit Elshani, tha se lidhur me modifikimin e “qendrave komunale të numërimit” për ne ende është e pakuptueshme, nuk e dimë formatin, dhe se na duhet një diskutim i brendshëm në këtë drejtim...Por, ne kemi lënë hapësira të mjaftueshme, formati nuk do të ndryshoj në tërësi... Ka nevojë për një shqyrtim dhe alaizë të brendëshme, edhe me sekretariatën...

3. Raportet e Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për realizimit e Planit të Punës të KQZ-së për periudhën janar-mars 2023:

Arianit Elshani: Kemi shqyrtuar në këshill edhe planin e punës, dhe kanë qenë të planifikuar 59 aktivitete dhe është paraparë që 13 aktivitetit të zhvillohen në këtë tremujorë, dhe 21 aktivitete janë realizuar pjesërisht, dhe një projekt nuk ka progres...Aktivitetet e tjera, mund të përfundojnë në gjashtëmujorin e ardhshëm, me përjashtim, një ose dy aktivitete, mund të stërzgjaten...

Fjala është për “historikun e zgjedhjeve”, dhe “trajnimi i trupave menaxhues”...Pra, këto mund ta tejkalojnë këtë gjashtë mujorë...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratim të këtij raporti ?

Me nëntë (9) vota për, plani i punës së KQZ-së për periudhën janar-mars 2023, miratohet.

Shqyrtimi dhe miratimi i konkursit për kompozimin e Melodisë së KQZ-së:

Arianit Elshani: Këshilli ma shqyrtuar edhe konkursin për “kompozimin’ e melodisë së KQZ-së. Ka qenë një rekomandim që, KQZ ta ketë një “melodi” të përhershme sepse, ne kemi paguar për çdo zgjedhje për informimin publik...Kjo, do të bëhet në bashkëpunim me fakultetin e arteve...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratim të kësaj pike ?

Me nëntë (9) vota për, miratohet konkursi për kompozimin e melodisë së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i agjendës për “Punëtorin për përmirësimin e listës së votuesve e përkrahur dhe financuar nga OSBE”:

Arianit Elshani: Kemi shqyrtuar këtë pikë lidhur me organizimin e një punëtorie që përkrahet e tëra nga OSBE. Punëtorja, ka në fokus “Listën votuese” ...Z. Elshani, e shpjegoi arsyetimin se pse, dhe cila është rëndësia e kësaj punëtorie... Data e mbajtjes planifikohet të jetë 30 maj, dhe si këshill rekomandojmë që të miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratim të kësaj punëtorie ?

Me nëntë (9) vota për, anëtarët e KQZ-së e miratuan agjendën e mbajtjes së kësaj punëtorie: “Përmirësimin e listës së votuesve”.

4. Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit tremujor financiar të KQZ-së për periudhën janar-mars 2023:

Gordana Llaban: Të nderuar, si këshill kemi mbajtur takimin e 6-të dhe, kemi shqyrtuar raportin tremujor financiar të KQZ-së për periudhën janar-mars 2023. KQZ sipas ligjit, i janë ndarë 6, 397 174 euro. Në kontekst, znj. Gordana shpjegoi se si janë të ndara këto mjete, në cilat sektorë, dhe për

çka...Ndërsa, ajo tha se KQZ për periudhën janar – mars ka shpenzuar 1, 359, 149 euro, ose 21, 2 % e buxhetit të planifikuar..

Në vazhdim, znj. Llaban e informoi KQZ edhe për kategoritë se sa, dhe ku janë bërë shpenzimet për këtë periudhë...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratim të këtij raporti ?

Me nëntë (9) vota për, anëtarët e KQZ-së e miratuan këtë raport tremujorë të shpenzimeve.

5. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

Njoftim nga pjesëmarrja në programin ndërkombëtar të vizitorëve në vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare në Estoni:

Kreshnik Radoniqi, kryesues i këtij këshilli tha se janë trajtuar 3 pika: 1. Kërkesa e AËEB-it për vëzhgimin e zgjedhjeve në Maldivë. 2. Vëzhgimi i zgjedhjeve në Mal të Zi. 3. Dhe, një shkresë që ka ardhur për Zyrën për pjesëmarrjen në një konferencë në Moldavi.

Për vëzhgimin e zgjedhjeve në Maldivë, vendosëm për shkak të shpenzimeve të mëdha të mos marrim pjesë. U dakorduam të marrim pjesë në Mal të Zi, nuk u përcaktuam për numrin...

Samiu, Iliri, Ibrahim, Fazliu dhe Albani e Rifati, kanë qenë here e kaluar.

Unë, Arianiti, Samiu, Gordana nga KQZ, a pajtoheni...? Nuk kemi marrë pjesë. Nga sekretariati, kush...? Nga Zyra...A bënë ti lëmë një nga Zyra dhe një nga Sekretariati...!

U vendos që: Kreshnik Radoniqi, Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Gordana Llaban të marrin pjesë, dhe një nga sekretariati, e një nga zyra...

Me 9 vota për, miratohet...

Për konferencë, shpenzimet janë të paguara nga ODIR-i, pra në Moldavi. Nuk e di si marrim pjesë, ftesën e kemi, por se di...Ftesa a për dy persona...

Kreshnik Radoniqi: Këtë, për pjesëmarrje e lëmë te Zyra, komunikimin le ta bëjë zyra...me rëndëi që pajtohem...

Kush është për...?

Me 9 vota për, miratohet...

Njoftim nga pjesëmarrja në programin ndërkombëtar të vizitorëve në vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare në Estoni.

Arianit Elshani, anëtarë i KQZ-së informoi lidhur me pjesëmarrjen në vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare në Estoni. Ai, tregoi se si, votohet në këtë vend, pra 50 % e votuesve kanë votuar në mënyrë elektronike, pa shkuar në vendvotime...

S'i përvojë, ishte shumë interesant. Pra, atje votohet përmes internetit. Në laptopët e tyre, votuesit shkarkojnë një aplikacion, e votojnë në zgjedhje...

Në imell, ju e keni një raport ku janë përvojat tona të vëzhgimit...Tani, ne mund të ndryshojmë QV-të, mund ti trajtojmë, sepse ka edhe vende, institucione tjera ku mund të votohet...

Por, na u tha se pa u digjitalizuar edhe institucionet e tjera, vetëm KQZ nuk mund ta bëjë...Pastaj, mirë është të ndryshohen kabinat e votimit me kosto më të lirë, të adoptohen etj.

Z. Elshani, raportoi edhe për formatet, dizajnët, numri i vogël i stafit të angazhuar në procese etj.

Në këtë pikë, diskutuan: **Sami Kurteshi, Burim Ahmetaj dhe Fazli Stollaj.**

Ndërsa, prezantimin e raportit të zgjedhjeve presidenciale, e bëri **Premtim Rrustemi** pjesëmarrës nga Sekretariati, i cili tha se ekipi I ka vëzhguar zgjedhjet me 19 prill, 2023. Ai, foli mbi sistemin zgjedhor, pasqyro një raport të detajuar të numrit të votuesve, qendrave të votimit, numrin e kandidatëve etj. Pastaj, edhe mbi organizimin dhe përgatitjen e procesit në aspektin teknik-material etj.

Në këtë pikë, gjithashtu foli edhe **Sami Hamiti**, i cili bëri një analizë të procesit presidencial atje, dallimet me sistemin tonë, shpalljen e rezultateve etj.

